



Pasqyra Makroekonomike publikohet nga Ministria e Financave çdo tre muaj dhe ka për qëllim informimin mbi zhvillimet tremujore ekonomike në Kosovë.


Sektori Real

Prodhimi i Brendshëm Bruto

Bazuar mbi publikimin e fundit të ASK-së, ekonomia e Kosovës gjatë tremujorit të tretë të 2018-ës shënoi rritje reale prej 3.4% dhe rritje nominale prej 1.9% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraardhës.

Rritja reale në tremujorin e tretë të vitit 2018 i atribuohet konsumit privat (me kontribut 5 pikë përqindje) dhe investimeve totale (me 6.8 pikë përqindje). Ndërsa, konsumi i qeverisë dhe eksportet neto kanë kontribuar negativisht në rritjen ekonomike me rreth 0.53 pp dhe 8.44 pp, respektivisht (Grafiku 1).


Grafiku 1. Kontributi i komponentëve në rritjen reale të BPV-së



Sipas aktiviteteve ekonomike, të dhënat e ASK-së për 2018T3 tregojnë se sektori i ndërtimitarisë ka patur kontributin më të madh në rritjen reale, me rreth 1.1 pp, duke qëndruar më lartë se kontributi i shënuar në dy tremujorët e parë të vitit 2018. Gjithashtu, kontributi i sektorit të shërbimeve ka

qenë pozitiv, rreth 1.6pp, dhe kontributi i bujqësisë vazhdon të jetë lehtësisht pozitiv, rreth 0.14pp. Ndërkohë, në tremujorin e tretë të 2018-ës, kontributi i sektorit të industrisë ka qenë negativ, rreth 0.3 pp (grafiku 2)

Grafiku 2. BPV-ja sipas aktiviteteve ekonomike



Në mungesë të të dhënave të ASK-së mbi rritjen ekonomike për tremujorin e katërt të 2018-ës, treguesit e tërthortë dhe paraprijës për kërkesën agregate dëshmojnë për një përmirësim më të përshpejtuar të rritjes ekonomike gjatë këtij tremujori. Ky përmirësim pritet të mbështetet kryesisht nga investimet (private dhe publike). Ndërsa, konsumi privat pritet të ketë një rritje më të ngadalësuar se në tremujorin e tretë dhe bilanci i tregtisë të jetë më i përkeqësuar.

Rritja e konsumit privat gjatë tremujorit të katërt të 2018 mbështetet nga zhvillimet në treguesit e tërthortë në krahasim me vitin paraardhës:

- rritja e importit të mallrave të konsumit me 2.7% (v-m-v);
- rritja e kompensimit të punëtorëve me 11.5% (v-m-v);
- rritja e remitencave me 5.6% (v-m-v);
- ndërkohë që kredia e re për qëllime konsumi shënoi ngadalësim me 9.8% (v-m-v)

Rritja e investimeve totale gjatë tremujorit të katërt të 2018-ës, mbështetet kryesisht nga investimet publike dhe private. Shpenzimet kapitale regjistruan rritje me rreth 24.0% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraardhës.

Përmirësimi i investimeve private gjatë 2018T4 pritet t'i atribuohet kryesisht:


- rritjes së importit të mallrave kapitale me 20.6% (v-m-v);
- rritjes së kredisë së re për qëllime investimi me 20% (v-m-v);
- rritjes së investimeve të huaja direkte me 82% (v-m-v);
- rritjes së bizneseve të reja neto (bizneset e reja minus bizneset e shuara) me 32% (v-m-v);
- përmirësimin të treguesit të klimës së biznesit gjatë 2018TM4;

Rritja reale për tre tremujorët e parë të vitit 2018 (janar –shtator) luhatet rreth vlerës 3.9% sipas të dhënave të ASK-së. Projektionet tona për gjithë vitin 2018 luhaten rreth vlerës 4.3%, e nxitur kryesisht nga investimet dhe konsumi privat. Kontribut të veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur dhe të vazhdojë të vijë nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra gjatë 2018-ës.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Përgjatë periudhës raportuese, **Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK)** ka vazhduar të ndjekë ecurinë rritëse që ka karakterizuar gjithë vitin 2018, por me ritme më të përshpejtuara në tremujorin e fundit.


Grafiku 3. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit



Më konkretisht, inflacioni vjetor shënoi vlerën 1.5%; 2.1% dhe 2.9% në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, respektivisht. Mesatarisht, norma mesatare e inflacionit për tremujorin e katërt të 2018-ës u luhat rreth vlerës 2.2% ndërsa për gjithë vitin kjo normë u luhat rreth vlerës 1.1% (grafik 3).

Kjo rritje e përshpejtuar e inflacionit në tremujorin e katërt i atribuohet jo vetëm sezonalitetit që karakterizon çmimet në fund të vitit, por edhe rritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe të naftës gjatë periudhës raportuese, të cilat më tej janë transmetuar në çmimet vendase, kryesisht për kategoritë “Ushqime” dhe “Transport”.

Grafiku 4. Inflacioni i tregtueshëm dhe i patregtueshëm



Edhe kategorizimi i inflacionit total sipas sektorit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm mbështet faktin që zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kanë dominuar ecurinë e indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë. Ashtu siç tregon grafiku 4, inflacioni i tregtueshëm është ai që i ka dhënë gjithë tonin inflacionit total në tremujorin e katërt të 2018-ës, ndërkohë që inflacioni i sektorit të patregtueshëm, i cili mat presionet inflacioniste me origjinë ekonomike të brendshme, ka qenë neglizhent.

Regjistri i Bizneseve dhe Klima e Biznesit

Nga të dhënat e ARBK-së (Tabela 1) vërejmë se në Kosovë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018-ës u regjistruan gjithsej 2,401 biznese të reja, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë 480 biznese të reja të regjistruara më shumë, ndërsa numri i bizneseve të çregjistruara arriti


vlerën 444 biznese apo 12 biznese më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Tabela 1. Bizneset e regjistruara sipas aktiviteve ekonomike

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM4 2017	TM4 2018
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria	131	156
Prodhimi	166	280
Ndërtimtaria	180	244
Tregtia me shumicë dhe pakicë	511	561
Akomodimi dhe akt. shërb.	183	252
Aktivitetet profesionale	171	212
Tjera	579	696
Totali	1,921	2,401

Megjithatë pritjet dhe vlerësimet e bizneseve vendore mbi pritjet ekonomike dhe të bërit biznes janë tregues të rëndësishëm për sinjalizimin e zhvillimeve të ardhshme ekonomike, në vijim janë të paraqitura të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës mbi gjendjen aktuale dhe pritjet e përgjithshme sipas vlerësimeve të bizneseve.


Grafiku 5. Klima e të bërit biznes në TM4 2018, gjendja aktuale



Të dhënat e tremujorit të katërt të vitit 2018 tregojnë se gjendja aktuale e shumicës së bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes ka qenë pozitive. Megjithatë, kjo klimë pozitive vlerësohet e përkeqësuar nga sektori i shitjes me pakicë dhe sektori i shërbimeve. Ndërsa, për tre sektorët e tjerë (shitja me shumicë, ndërtimtaria dhe përpunimi), klima pozitive ka qëndruar pothuajse e pandryshuar (grafiku 5). Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, klima e

biznesit ka shënuar rritje të theksuar për të gjitha kategoritë e bizneseve.


Grafiku 6. Klima e biznesit në TM4 2018, pritjet e përgjithshme



Në grafikun 6 janë paraqitur pritjet e përgjithshme për klimën e biznesit për 6 muajt e ardhshëm, ku shihet se në të gjithë sektorët klima e biznesit është vlerësuar të jetë pozitive dhe në përmirësim në krahasim me gjendjen aktuale.

Grafiku 7 prezanton pritjet për punësim të bizneseve të anketuara për gjashtë muajt në vijim. Vlen të theksohet se në përgjithësi pritshmëritë e bizneseve janë pozitive, përveç sektorit të ndërtimtarisë, pritshmëritë e të cilit për punësim kanë qenë lehtësisht negative për 6 muajt e ardhshëm, dhe rrjedhimisht jo në linjë me pritjet e këtij sektori për klimën e biznesit.

Grafiku 7. Pritjet për punësim në TM4 2018 për gjashtë muajt e ardhshëm



Importi i mallrave gjatë tremujorit të katërt të 2018-ës ka vazhduar të ketë trend rritës, duke shënuar rritje prej 6.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Tabela 2 tregon katër grupe produktesh që përbëjnë më shumë se gjysmën e importeve të mallrave. Rritja e importeve gjatë tremujorit të katërt i atribuohet rritjes së të gjitha kategorive të importit, me përjashtim të kategorisë “Ushqime të përgatitura, pije dhe duhan”, e cila ka shënuar rënie vjetore me rreth 3.5%.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në ‘000 euro

Kategoria	TM4 2017	TM4 2018
Produkte minerale	120,652	143,420
Ushqime të përg. pije dhe duhan	102,149	98,565
Makineri, pajisje makinerie e elektrike	105,095	113,838
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	82,869	92,015
Të tjera	419,344	438,973
Totali	830,109	886,811

Tabela 3 paraqet strukturën e importeve sipas shteteve, ku vihet re se gjatë tremujorit të katërt të 2018-ës, tre vendet që kanë pjesëmarrje më të lartë të importit në Kosovë janë Gjermania, Turqia, Kina, për t’u ndjekur nga Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia. Ndërkohë, në periudhën e njëjtë të vitit paraprak Serbia ka qenë vendi me pjesëmarrjen më të lartë në importet e mallrave në Kosovë. Rënia vjetore e importeve me origjinë nga Serbia me rreth 51% në tremujorin e katërt të 2018-ës është kompensuar nga rritja e importeve me origjinë nga vendet e tjera: Sllovenia me rritje 101%; Shqipëria me rritje 54%; Turqia me rritje 22%; Kina me 15% dhe Maqedonia me 17%.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në ‘000 euro

Shteti	TM4 2017	TM4 2018
Gjermania	108,210	103,149
Turqia	77,390	94,688
Kina	76,174	87,967
Shqipëria	39,299	60,522
Serbia	121,845	58,687
Maqedonia	41,441	48,497
Sllovenia	18,054	36,305
Të tjera	347,696	396,995
Total	830,109	886,810

Sa i përket eksporteve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, ato kanë shënuar rritje prej 9.5% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm.

Sipas kategorive të produkteve të eksportuara, Tabela 4 tregon se eksportet e metaleve bazë dhe eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës në 2018TM4 janë rritur me rreth 17.7% dhe 26.7%, respektivisht në terma vjetorë. Ndërkohë, eksportet e produkteve minerare kanë shënuar rënie vjetore prej 32.7% gjatë periudhës raportuese.

Tabela 4. Eksportet sipas produkteve, në ‘000 euro

	TM4 2017	TM4 2018
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	34,001	40,013
Produktet minerale	15,229	10,253
Plastika, goma dhe artikujt prej tyre	9,891	12,529
Të tjera	34,506	39,680
Total	93,627	102,475

Gjatë tremujorit të katërt të 2018-ës rreth 71.2% e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së.

Në Tabelën 5, vihet re se eksporti me Serbinë dhe me Malin Zi ka rënë, ndërkohë që eksporti me vendet e tjera, veçanërisht me Shqipërinë, Indinë, Gjermaninë dhe Zvicrën është rritur gjatë periudhës raportuese.

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në ‘000 euro

Shteti	TM4 2017	TM4 2018
Shqipëria	16,388	19,657
India	14,270	17,479
Maqedonia	10,370	10,776
Serbia	11,000	7,684
Zvicra	5,622	7,448
Gjermania	5,858	7,299
Mali i Zi	5,113	4,904
Te tjera	25,004	27,228
Total	93,627	102,475


Të dhënat e disponuara për ecurinë e bilancit tregtar të shërbimeve janë të pjesshme dhe mbulojnë zhvillimet vetëm për muajt tetor dhe nëntor të vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe, eksporti

i shërbimeve është rritur me 12.7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i shërbimeve të ndërtimit, të shërbimeve të biznesit; të shërbimeve kompjuterike dhe informatike dhe shërbimeve të transportit, ndërkohë që shërbimet e udhëtimit kanë shënuar rënie vjetore.

Importi i shërbimeve gjithashtu ka shënuar rritje vjetore gjatë periudhës tetor-nëntor 2018 me rreth 18.1%, si rezultat i rritjes së shërbimeve të biznesit, të shërbimeve kompjuterike, informatike dhe telekomunikacionit dhe shërbimeve të transportit.

Si rezultat i zhvillimeve në importe dhe eksporte të mallrave dhe shërbimeve, bilanci tregtar gjatë muajve tetor-nëntor 2018 shënoi vlerën prej -473.4 milionë Euro ndërkohë që ky bilanc në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte -431.8 milionë Euro (grafiku 7).

Grafiku 7. Bilanci Tregtar i Mallrave dhe Shërbimeve¹




Sektori Fiskal²

Të hyrat e përgjithshme buxhetore shënuan rritje prej 5.7% në tremujorin e katërt të vitit 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje reflektohet në të gjitha kategoritë e të hyrave: të hyrat nga tatimet direkte me 24.9 %; indirekte me 0.2%; dhe të hyrat jo-tatimore me 12.5% (grafiku 8). Kjo rritje në arkëtim vjen si rrjedhojë e aktivitetit të shtuar ekonomik, rritjes së vëllimit të shpenzimeve të sektorit publik, rritjes së importeve, përmirësimin e ambientit të të bërit


biznes dhe efijencës së agjencive mbledhëse si rezultat i reformave strukturore.

Grafiku 8. Të hyrat, në milionë euro



Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, ato gjithashtu shënuan një rritje prej 10.2% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Një ngritje më e theksuar shihet tek shpenzimet kapitale me 24.0%, ndërsa ato rrjedhëse janë rritur për 3.4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 9).

Grafiku 9. Shpenzimet, në milionë euro




Si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të shpenzimeve qeveritare krahasuar me arkëtimin e të hyrave në këtë periudhë, deficitin buxhetor sipas rregullës fiskale sipas grafikut 10 ka shënuar ngritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

¹ Të dhënat e bilancit tregtar për 2018TM4 mbulojnë vetëm dy muaj: tetor dhe nëntor 2018, sepse mungojnë të dhënat e bilancit të shërbimeve për muajin dhjetor.

² Të dhënat mbi treguesit fiskalë për muajin dhjetor 2018 janë preliminare.

Grafiku 10. Deficiti Primar, në milionë euro



Sektori Bankar

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të mbetet i mirëkapitalizuar, likuid dhe profitabil. Duke u bazuar në të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, stoku i depozitave shënoi një rritje vjetore prej 8.8% në tremujorin e katërt të 2018-ës. Në anën tjetër, stoku i kredive vazhdoi të regjistronte rritje dy-shifrore prej 10.9%.


Asetet totale të sistemit bankar shënuan rritje prej 7.9%, duke arritur në 4.18 miliardë euro në fund të periudhës raportuese. Raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit ka rënë në 2.7% në fund të tremujorit të katërt të 2018 nga niveli 3.1% të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kosova vazhdon të jetë vendi me normën më të ulët të kredive jo-performuese në rajon (Tabela 6).

Tabela 6. Treguesit kryesorë të sistemit bankar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro).

	TM4 2017	TM4 2018
Depozitat	3,092	3,365
Kreditë	2,485	2,755
Asetet Totale	3,877	4,184
Kreditë Jo-Performuese	3.1%	2.7%

Norma e interesit të kredive të reja ka rënë nga 6.8% në dhjetorin e vitit 2017, në 6.0% në dhjetorin e vitit 2018. Ndërsa, norma e interesit të depozitave është rritur nga 1.12% në tremujorin e katërt të 2017 në 1.4% në tremujorin e katërt të 2018. Si rrjedhojë, hendeku ndërmjet normës së interesit të kredive dhe asaj të depozitave është ngushtuar në 4.9 pp në tremujorin e katërt të 2018-ës nga 5.7 pp që shënonte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Grafiku 11).

Grafiku 11. Trendi i normave të interesit dhe depozitave



Tabelë Përmbledhëse

Përshkrimi	Njësia	2016	2017				2018			
			TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
SEKTORI REAL										
Bruto Produkti Vendor	çmime konst., ndryshimi në %	3.9	2.7	4.3	4.4	3.2	3.5	4.7	3.4	:
IÇK	ndryshimi në %	0.3	1.6	1.9	1.7	0.7	0	0.7	1.4	2.2
Ushqimi dhe pijet	ndryshimi në %	-0.4	1	1.9	1.4	1.9	0.6	0.5	2.0	3.1
Çmimet e importit	ndryshimi në %	-2.5	5.2	4.3	4.2	2.5	1.4	2.4	2.2	:
Çmimet e prodhimit	ndryshimi në %	-0.1	0.9	5.5	5.6	1.6	0.2	1.7	2.3	:
TREGU I PUNËS										
Norma e punësimit	ndryshimi në %	28	28.9	29.9	30.4	29.8	28.8	28.5	29.1	:
Norma e papunësisë	ndryshimi në %	27.5	30.5	30.6	30.2	30.6	26.5	29.4	30.7	:
Numri i bizneseve të regjistruara		10,424	280	2,237	2,215	1,921	2,556	2,636	2,212	2,401
Numri i bizneseve të ç' regjistruara		2,360	429	444	298	432	486	412	339	444
SEKTORI I JASHTËM										
Importi i mallrave	c.i.f., mil. euro	2,790	609	787	821	830	656	887	910	887
Eksporti i mallrave	f.o.b., mil. euro	310	76	103	105	94	73	96	96	102
Bilanci tregtar	mil. euro	-2,480	-533	-684	-716	-736	-582	-791	-814	-785
Importi i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	3,282	707	905	1,007	955	776	1,032	1,121	978*
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	1,440	235	305	874	296	268	334	847	231*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	mil. euro	-481	-169	-252	232	-194.8	-157	-267	152	-185*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	% e BPV	-7.9	-14	-16	13	-12	-2	-4	2	-2.7*
Investimet e Huaja Direkte	bilanci, mil. euro	220	65	84	64	42	31	49	90	49.1*
Remitencat	bilanci, mil. euro	691	163	197	194	205	170	214	203	143.5*
SEKTORI FISKAL										
Të hyrat e përgjithshme	mil. euro	1,596	339	415	475	453	352	439	498	468
Të hyrat nga tatimet direkte	mil. euro	232	57	62	60	59	59	72	65	73
Të hyrat nga tatimet indirekte	mil. euro	1,227	253	321	380	361	258	339	390	357
Shpenzimet e përgjithshme	mil. euro	1,658	342	418	417	574	401	434	461	633
Shpenzimet rrjedhëse	mil. euro	1,221	286	315	296	386	320	332	347	399
Shpenzimet kapitale	mil. euro	444	56	103	121	188	81	102	114	233
SEKTORI BANKAR										
Depozitat	mil. euro	2,898	2,912	2,888	3,047	3,093	3,074	3,086	3,210	3,365
Kreditë	mil. euro	2,230	2,295	2,391	2,407	2,485	2,534	2,661	2,681	2,755
Asetet totale të sektorit bankar	mil. euro	3,637	3,670	3,671	3,811	3,876	3,873	3,891	4,033	4,184
Norma e interesit në kredi	%	7.5	7.3	6.7	6.6	6.8	6.9	6.7	6.7	6.0
Norma e interesit në depozita	%	1.01	0.9	1	1.1	1.1	1.1	1.1	1.4	1.5
Norma reale efektive e këmbimit	indeks	104.6	105.9	104.6	104.8	104.5	104.8	103.8	104.3	105.9

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna: në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi * të dhënat përfshijnë periudhën Tetor-Nëntor, pasi që në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre, nuk janë të publikuara të dhënat për muajin Dhjetor/ Diskrepancat e mundshme me publikime tjera të Njësisë vijnë si pasojë përpunimit të të dhënave nga BQK, pasuar edhe me revidim historik.

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Janar 2019